



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1581/prot.,
13

Tiranë, më 17.08.2026

VENDIM

Nr. 43, datë 17.08.2026

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK TË ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT
TË MJEKËSISË, TIRANË, 2025-2030”**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë, në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 49, pika 1, shkronja b), në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, i ndryshuar, neni 51, pika 1, shkronja c), në Vendimet e Senatit Akademik nr.153, datë 19.12.2025 “Për miratimin në parim të Planit Strategjik të Zhvillimit të UMT-së, 2025-2030”, si dhe në Vendimin nr. 96, datë 31.07.2026 “Për një shtesë në planin strategjik të zhvillimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, 2025-2030, miratuar me vendimin nr. 153, datë 19.12.2025”, në mbledhjen e datës 17.08.2026, Bordi i Administrimit të UMT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për periudhën 2025-2030, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Vendimi i përcillet Rektorit dhe Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETARI

VANGJUSH STAVRO

ANËTARË

MONIKA FIDA


VERA OSTRENI

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË 2025-2030

Miraturar me Vendimin nr. 153, datë 19.12.2025 të Senatit Akademik të
Universitetit të Mjekësisë, Tiranë

Tiranë, 2025

VIZIONI

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë synon të konsolidojë dhe forcojë rolin e tij si institucioni udhëheqës akademik dhe kërkimor në shkencat e shëndetit në nivel kombëtar, duke u pozicionuar njëkohësisht si një partner aktiv, i besueshëm dhe konkurrues në hapësirën evropiane dhe globale të arsimit të lartë mjekësor dhe kërkimit shkencor.

Ky rol kyç dhe udhërrëfyes në edukim, kërkim shkencor dhe kujdes shëndetësor do të realizohet përmes:

- ndërkombëtarizimit të veprimtarisë akademike dhe kërkimore;
- harmonizimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel ekselence në të tre ciklet e studimit;
- promovimit dhe zhvillimit të kërkimit shkencor të pavarur, inovativ dhe afatgjatë në fushat prioritare të kujdesit shëndetësor;
- ndërtimit të një mjedisi universitar miqësor, gjithëpërfshirës dhe të digjitalizuar;
- kultivimit të ekselencës akademike, shkencore dhe profesionale;
- adresimit në mënyrë aktive të nevojave të shoqërisë dhe të sistemeve të kujdesit shëndetësor.

MISIONI

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë është një institucion publik i arsimit të lartë mjekësor, misioni i të cilit është të krijojë, zhvillojë dhe transmetojë dije përmes mësimdhënies cilësore, kërkimit shkencor dhe inovacionit, në shërbim të shëndetit publik dhe shoqërisë.

Në përmbushje të këtij misioni, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë angazhohet:

- Të formojë profesionistë të kualifikuar dhe shkencëtarë të rinj në fushën e shkencave të shëndetit;
- Të bashkëpunojë me studentët, institucionet publike, sistemin shëndetësor dhe shoqërinë civile për përmirësimin e kujdesit shëndetësor;
- Të promovojë ndërkombëtarizimin e arsimit mjekësor dhe kërkimit shkencor;
- Të mbështesë formimin profesional të vazhdueshëm dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Të kontribuojë në zhvillimin shoqëror dhe ekonomik në nivel kombëtar;
- Të nxisë inovacionin dhe risitë në shkencat mjekësore;
- Të edukojë dhe frymëzojë liderët e së ardhmes në fushën e mjekësisë.

QËLLIMI

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, si institucioni i vetëm publik në fushën e shkencave mjekësore, ka për qëllim të ruajë dhe forcojë rolin e tij udhërrëfyes në përballjen e sfidave bashkëkohore dhe të ardhshme të kujdesit shëndetësor, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe evropiane, përmes formimit të profesionistëve të shëndetit të kualifikuar, etikë dhe konkurrues.

Ky qëllim realizohet duke orientuar arsimin, kërkimin dhe shërbimin universitar drejt:

- ofrimit të kujdesit mjekësor të bazuar në evidenca shkencore dhe praktika të provuara, në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore;
- harmonizimit të mësimdhënies dhe zhvillimit të kompetencave profesionale në të tre ciklet e studimit, në përputhje me standardet më të larta akademike dhe kërkesat e sistemeve bashkëkohore të kujdesit shëndetësor;
- promovimit të kërkimit shkencor inovativ dhe ndërdisiplinor në fushat prioritare të kujdesit shëndetësor, me impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin publik dhe shoqëri;
- forcimit të ndërkombëtarizimit përmes bashkëpunimit akademik dhe kërkimor, mobilitetit dhe partneriteteve strategjike në hapësirën evropiane dhe globale të arsimit të lartë mjekësor;
- zhvillimit të modeleve bashkëkohore të kujdesit shëndetësor, duke nxitur kalimin nga kujdesi spitalor drejt kujdesit ambulator, komunitar dhe në shtëpi;
- promovimit të mjekësisë së integruar, proaktive dhe parandaluese, të mbështetur në punën e ekipeve profesionale multidisiplinare dhe interdisiplinare;
- ndërtimit dhe garantimit të një partneriteti etik, transparent dhe të qëndrueshëm ndërmjet profesionistëve të shëndetësisë dhe pacientëve.

OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, është formimi i profesionistëve të shëndetit të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjekësore.

4.1 Ndërkombëtarizim të UMT-së, si pjesë e dialogut global me shoqërinë bashkëkohore;

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, do të zhvillojë dhe forcojë ndërkombëtarizimin e veprimtarisë së tij akademike dhe kërkimore, përmes proceseve që synojnë integrimin e vlerave, praktikave dhe standardeve globale, ndërkombëtare dhe ndërkulturore në objektivat dhe përmbajtjen e arsimit të lartë mjekësor. Ky proces përfshin të gjitha nivelet dhe aktorët e universitetit, përfshirë studentët, personelin akademik dhe stafin administrativ.

Institucionet e arsimit të lartë mjekësor synojnë natyrshëm ndërkombëtarizimin si një nga mjetet më efektive për rritjen e cilësisë së studimeve dhe kërkimit shkencor, duke nxitur shkëmbimin e përvojave, bashkëpunimin akademik dhe rritjen e vizibilitetit ndërkombëtar të institucionit. Me prioritet do të jenë:

- Hartimi i strategjisë së ndërkombëtarizimit të UMT-së në kuadër të punës së përbashkët me gjithë grupet e interesit për implementimin e Politikave Kombëtare të Ndërkombëtarizimit të IAL-ve.

- Rritja e vazhdueshme të partneritetit dhe bashkëpunimit me universitetet e huaja të hapësirës evropiane të arsimit të lartë.
- Forcimi i vazhdueshëm të partneritetit të UMT-së me programet e shkëmbimit ERASMUS.
- Rritja dhe mbështetja institucionale të shkëmbimeve studimore të pedagogëve dhe studentëve me institucionet e huaja të arsimit të lartë.
- Aplikimi në shkallë të gjerë të mobiliteteve ndërkombëtare në formën e doktoraturave të përbashkëta ose me ko-tutelë.
- Prezantimi i formave inovative të mobiliteteve digjitale (virtuale), ose si formate hibride të mobiliteteve fizike/virtuale në të tre ciklet e studimeve në UMT.
- Fillimi i punës për implementimin e kurrikulës të programeve të studimit në gjuhën angleze për tërheqjen e studentëve të huaj në UMT.
- Rritja e pjesëmarrjes së pedagogëve, studentëve dhe stafit administrativ në aktivitete, konferenca dhe trajnime ndërkombëtare, duke parashikuar edhe mbështetje financiare institucionale për këtë qëllim.
- Rritja e vizibilitetit të UMT-së dhe aktiviteteve universitare nëpërmjet përmirësimit të Website dhe publikimeve të aktiviteteve në gjuhën angleze.
- Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor të stafit akademik dhe studentëve.
- Rritja e bashkëpranisë së UMT-së në konferenca, projekte dhe aktivitete ndërkombëtare, duke parashikuar edhe mbështetje financiare institucionale.
- Ngritja e Qendrës së Gjuhëve të Huaja pranë UMT-së për të trajnuar dhe përditësuar falas stafin akademik dhe mbështetur mësimdhënien për studentët.
- Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës së kërkimit shkencor dhe vijimin e projektit madhor të Qendrës Multifunksionale të Simulimit Klinik.
- Ngritja e platformave digjitale të informatizuara të komunikimit në funksion të strategjisë së mësipërme të ndërkombëtarizimit në UMT.

4.2 Harmonizim në nivel ekselence të mësimdhënies në të treja ciklet e studimeve;

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë do të kontribuojë në mënyrë aktive në zhvillimin e shkencave të shëndetit, përmes asimilimit të dijeve bashkëkohore dhe krijimit të njohurive të reja, duke forcuar rolin e tij në hapësirën akademike shqiptare dhe më gjerë. Në përgjigje të rritjes së vazhdueshme të nevojave të sistemeve të kujdesit shëndetësor dhe shtimit të numrit të studentëve, Universiteti do ta shohë këtë sfidë si një mundësi reale për rinovimin, harmonizimin dhe përditësimin e programeve të studimit, si dhe për forcimin e kapaciteteve dhe potencialit akademik të institucionit.

Në këtë kuadër, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë do të angazhohet për të ofruar rezultate konkrete dhe me impakt të matshëm për shoqërinë, duke kultivuar një kulturë institucionale të të mësuarit të vazhdueshëm, përditësimit të dijeve dhe përgjegjshmërisë akademike ndaj nevojave të shoqërisë. Me prioritet do të jenë:

- Promovimi i metodologjive të mësimdhënies që stimulojnë kreativitetin e studentëve nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në studime shkencore dhe projekte zhvillimore, studimit të personalizuar etj.
- Rinovimi i vazhdueshëm i kurrikulave universitare në drejtim të rritjes së aftësive praktike dhe metodologjisë së kërkimit shkencor.
- Rritja e qëndrueshme e numrit të studentëve në të gjithë programet e studimit në përputhje me kërkesat e shtuara të sistemeve të kujdesit shëndetësor.
- Shtimi i numrit të pedagogëve efektivë për përballimin me cilësi të ngarkesës mësimore të shtuar.
- Ristrukturimi i burimeve njerëzore të stafit akademik dhe ndihmës akademik e administrativ në përgjigje të rritjes së numrit të studentëve në universitet.
- Fillimi i punës për projektin e Kampusit të Rinovuar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, që përfshin edhe vijimin e projektit madhor të Qendrës Multifunkionale të Simulimit Klinik.
- Harmonizimin e mësimdhënies të shkencave bazë mjekësore për të gjitha programet e studimit të UMT-së.
- Krijimi i një hapësire të përbashkët universitare për promovimin daktoral dhe akademik në kuadër të harmonizimit të programeve të studimit të ciklit të tretë dhe mbështetjes së vazhdueshme të personelit akademik.
- Fillimi i punës për projektin zhvillimor të 'e-universitetit' mbi digjitalizimin e pjesshëm të procesit mësimor me fokus në aplikimet e Inteligjencës Artificiale (AI), materialeve didaktike digjitale online, simulimin klinik në aftësimin praktik, e-laboratorët, edukimin në distancë, Telemjekësinë dhe Teleshëndetin, tutorialet e ndryshme etj.
- Prezantimi i ciklit të studimeve post-doktorale sipas tematikës së përzgjedhur bashkëkohore të fushave prioritare të kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Fuqizimi i vazhdueshëm i Qendrës së Zhvillimit Profesional në UMT për ofrimin e programeve të qëndrueshme të Edukimit në Vazhdim dhe Të Mësuarit Gjithë Jetën për profesionistët e shkencave të shëndetit.

4.3 Kërkim shkencor inovativ në fushat prioritare të kujdesit shëndetësor;

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë do të rrisë sasinë, cilësinë dhe efektivitetin e kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit, duke nxitur kërkimin ndërdisiplinor dhe integrimin e kërkimit bazë me atë klinik, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Universiteti do të angazhohet për pjesëmarrje aktive në projekte kërkimore kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, me synim zgjerimin e kufijve të dijes mjekësore dhe rritjen e ndikimit shkencor dhe shoqëror të kërkimit. Parimi udhëheqës i këtij angazhimi mbetet transformimi i dijes dhe shkencës mjekësore në inovacione, projekte dhe produkte, në shërbim të pacientëve, shoqërisë dhe njerëzimit. Me prioritet do të jenë:

- Ruajtja e rritjes së qëndrueshme të publikimeve shkencore të stafit akademik të UMT-së në periodikët shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.
- Implementimi i projekteve të investimeve në infrastrukturën e kërkimit shkencor (laboratorë, baza të dhënash informatike, instrumenta shkencorë etj).
- Rritja e kapaciteteve të shkrimit dhe hartimit të projekteve në UMT me fokus kërkimin shkencor në shkencat e shëndetit.
- Krijimi i Grupeve Akademike Klinike (GAK), si forume tematike për kërkimin dhe kërkuesit shkencorë ndërmjet disiplinave mjekësore për të përmirësuar bashkëveprimin midis kërkimit shkencor bazë dhe klinik, me synim forcimin e bashkëpunimit me ofruesit e kujdesit shëndetësor.
- Lehtësimi, brenda kuadrit ligjor në fuqi, të procedurave të nevojshme administrative të aplikimit në grantet dhe projektet e kërkimit shkencor.
- Rritja e vizibilitetit të kërkimit shkencor në UMT nëpërmjet ndërkombëtarizimit dhe publikimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të stafit akademik.
- Rritja e pjesëmarrjes së UMT-së në projekte rajonale dhe ndërkombëtare që lidhin kërkimin shkencor me edukimin mjekësor; duke nxitur kërkimin shkencor me vlera për pacientët dhe shoqërinë në përgjithësi.
- Fillimi i punës për projektin e ngritjes në universitet të një Qendre të Studimeve Post-doktorale sipas fushave kryesore të kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Mbështetje financiare dhe infrastrukturale për stafin akademik dhe studentët për projektet e kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës së bibliotekave shkencore fizike dhe virtuale në UMT në drejtim të pasurimit me literaturë mjekësore bashkëkohore.
- Publikimin në gjuhën angleze të gjithë revistave shkencore në UMT me synim rritjen e vizibilitetit të kërkimit shkencor.

4.4 Mjedis universitar miqësor nëpërmjet informatizimit të procedurave akademike dhe administrative, si edhe mbështetjes së stafit universitar.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë do të krijojë dhe zhvillojë një mjedis universitar miqësor, të sigurt dhe empatik për pedagogët, studentët dhe stafin ndihmësakademik e administrativ, duke promovuar vlera konstruktive, bashkëpunuese dhe etike në të gjitha nivelet e veprimtarisë universitare. Universiteti do të vlerësojë dhe mbështesë rolin thelbësor të stafit akademik, administrativ dhe studentëve, duke njohur se impakti pozitiv i UMT-së në shoqëri buron nga angazhimi, profesionalizmi dhe puna e tyre e përbashkët.

Në këtë kuadër, prioriteti kryesor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë do të jetë mirëqenia e komunitetit universitar në mjedisin e punës dhe të mësimin, si dhe mbështetja e zhvillimit dhe realizimit individual të karrierës akademike dhe profesionale, duke e shndërruar universitetin në një institucion gjithëpërfshirës, mësimnxënës dhe lehtësues të pjesëmarrjes aktive dhe komunikimit të hapur.

- UMT-ja do të lehtësojë zhvillimin akademik dhe profesional të karrierës së stafit akademik dhe administrativ, duke u fokusuar në planet individuale të karrierës dhe planin e masave të përgjithshme për ndërtimin e karrierës.
- UMT-ja në mënyrë të përshkallëzuar do të implementojë metodat inovative të të mësuarit digjital ('e-learning') dhe do të prezantojë një platformë digjitale unike ('e-universiteti') për të gjitha llojet e aplikimeve, si në fushën akademike, ashtu edhe për procedurat administrative.
- UMT-ja synon të mbështesë jo vetëm karrierën individuale, por edhe të përkujdeset për mirëqenien kolektive dhe komunikimin e ndërsjelltë empatik mes kolegëve, stafit administrativ e studentëve; në respekt të individualitetit dhe etikës institucionale.
- Zyrat e Karrierës në UMT do të mbështesin aktivisht në nivel individual dhe kolektiv planet e zhvillimit të karrierës për stafin universitar dhe studentët.
- UMT-ja synon mbështetjen financiare të stafit akademik sipas kuadrit ligjor në fuqi duke e shtrirë biapartenencën me sistemet e ofruesve të kujdesit shëndetësor për të gjithë pedagogët e universitetit.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të ushtrimit të aktivitetit akademik e profesional të stafit universitar nëpërmjet hapjes së universitetit ndaj shoqërisë, duke shfrytëzuar të gjitha burimet financiare ligjore si psh. projektet inovative, partneritetin publik-privat, donacionet, etj.
- Zhvillimin e mbështetjes financiare për studentët e të gjitha cikleve të studimit, duke i përfshirë sipas kuadrit ligjor në fuqi në shërbimet administrative dhe punën universitare në përgjithësi.
- Përfshirjen në shkallë të gjërë të stafit akademik, administrativ dhe studentëve në projektet e kërkimit shkencor me financime rajonale dhe ndërkombëtare.

4.5 Studentët

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë prej vitesh pranon studentët më të mirë në nivel kombëtar dhe më gjerë, universiteti është i ndërgjegjshëm se angazhimi i plotë dhe sukcesi akademik i studentëve janë të lidhura ngushtë me përmbushjen e nevojave të tyre jetike dhe sociale bazë. Në këtë kontekst, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë do të mbështesë në mënyrë aktive studentët, veçanërisht ata me potencial të lartë akademik dhe kërkimor, duke krijuar kushte të favorshme për përfshirjen e tyre të qëndrueshme në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe jetën universitare.

Rinovimi i vazhdueshëm i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë kërkon zhvillimin profesional të studentëve të talentuar dhe të ekipeve të reja kërkimore, si dhe ndërtimin e mekanizmave mbështetës që mundësojnë realizimin e plotë të potencialit të tyre akademik dhe profesional. Realizimi i këtij objekti synohet nëpërmjet:

- Pjesëmarrjes së shtuar të studentëve të tre cikleve të studimit në projektet e kërkimit shkencor të fushave prioritare të shkencave të shëndetit.
- Përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës universitare në drejtim të rritjes së përqindjes të praktikave klinike, laboratorëve dhe punës së pavarur të studentëve.

- Ofrimit të mësimdhënies të bazuar në praktikën klinike universitare dhe kërkimin shkencor në fushat prioritare të shkencave të shëndetit.
- Përgatitjes së rinovimit të kurrikulës universitare të shkencave të shëndetit me fokus në rritjen e numrit të studentëve në të gjitha programet e studimit në UMT.
- Ofrimit në nivel universiteti të Kurseve të Aftësive Klinike mbi bazën e modeleve më të mira bashkëkohore, për të mundësuar aplikimin e studentëve në sistemet e ofruesve të kujdesit shëndetësor gjatë kohës së studimeve.
- Krijimin e një hapësire të përbashkët për Aftësimin Klinik për të gjithë studentët e universitetit mbi parimin e mundësive të barabarta dhe shtrytëzimit të përbashkët të infrastrukturës universitare.
- Organizimin e Internshipeve dhe Kurseve të Formimit Profesional për studentët në bashkëpunim e marrëveshje me sistemet e ofruesve të kujdesit shëndetësor.
- Strukturimin në nivel universiteti të Grupeve Shkencore të Studentëve sipas fushave prioritare të kërkimit shkencor në shkencat e shëndetit.
- Fillimin e bashkëpunimit me autoritetet shtetërore në drejtim të aplikimit dhe fuqizimit të skemave të Kredisë Studentore për mbështetjen financiare të studentëve.

4.6 Financimi

Për të realizuar objektivat, një rol të rëndësishëm luan financimi që siguron universiteti. Dy burimet aktuale të financimit janë grantet nga Buxheti i Shtetit dhe të ardhurat dytësore, që krijohen kryesisht nga tarifat e studimit. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” krijon hapësira të rëndësishme për të përmirësuar financimin, duke siguruar financime alternative.

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, ka si qëllim të fuqizojë financat e tij përmes:

- përmirësimit të efektivitetit dhe efikasitetit të financave të tij;
- rritjes së të ardhurave nëpërmjet nxitjes dhe përfshirjes në projekte kërkimore-shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- shtimi dhe zgjerimi i shërbimit në kuadër të ofrimit të programeve të edukimit në vazhdim për të gjithë profesionistët e shëndetit të Shqipërisë;
- ofrimit të konsulencës dhe shërbimeve për të tretët;
- rritjes së përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor;
- përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve, duke rritur transparencën dhe efikasitetin e tyre;
- ofrimit të fellowship-eve post-specialiteti, me kohëzgjatje 3, 6, 12 dhe 18-mujore, në fusha mjekësore të caktuara, për të cilat kërkohet një formim i veçantë post specialitetit bazë;
- fuqizimit të sistemit on-line të bibliografisë shkencore të stafit akademik dhe përditësimit në vazhdimësi të tij.

4.7 Organizimi administrativ

Realizimi i synimeve të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe detyrimeve që rrjedhin nga reflektimi i ndryshimeve ligjore në zbatim të Ligjit nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, pas përfundimit të fazës së parë mbi riorganizimin e brendshëm dhe rivlerësimin e dokumentacionit bazë të universitetit, tashmë synohet konsolidimi dhe fuqizimi i të gjithë strukturës së re organizative të UMT, e kryesisht të njësive/strukturave të reja, duke i mbështetur me akte rregullative për funksionimin e tyre. Me prioritet do të jetë:

- ngritja dhe fuqizimi i strukturës përgjegjëse për aplikimin e projekteve dhe përthithjen e fondeve për UMT.

4.8 Bashkëpunimi me partnerët vendas dhe të huaj; Projektet studimore, kërkimore e shkencore

Rektorati i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, Senatin Akademik, dekanatet dhe departamentet, do të jetë koordinatori dhe nxitësi, që do të promovojë:

- pavarësinë dhe lirinë akademike dhe institucionale;
- përf forcimin e rolit koordinativ të strukturave të fakulteteve;
- rritjen dhe forcimin e kompetencave të departamenteve, me synim kthimin e tyre në motorin evendimmarrjes;
- nxitjen dhe përpunimin e strategjive të zhvillimit dhe edukimit;
- rritjen e kompetencave akademike dhe profesionale të shërbimeve universitare, duke i mbrojtur dhe i promovuar ato si vlerat më të shenjta të sistemit akademik mjekësor dhe më gjerë;
- përf forcimin e integritetit dhe kompetencave të stafit akademik;
- krijimin e strukturave të reja, të cilat sigurojnë transparencën dhe efektshmërinë e shpenzimeve financiare;
- fuqizimin e strukturave mbështetëse që do të sigurojnë ofrimin e programeve të edukimit në vazhdim, fellowshipe-ve dhe mbështetjen për përpilimin e projekteve.

4.9 Infrastruktura

Tashmë që ka kaluar periudha e mbushur me sfida e konsolidimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, vitet e ardhshme janë shumë të rëndësishme për të hedhur hapat e duhur drejt modernizimit dhe krijimit të risive që kërkon koha dhe edukimi mjekësor dhe përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës të UMT do të jetë një prioritet.

Me qëllim:

- Vendosjen e një infrastrukture universitare moderne dhe të integruar, e cila mbështet në mënyrë efikase mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe shërbimet administrative.
- Krijimin e kushteve fizike dhe teknologjike që garantojnë cilësi, siguri dhe akses të barabartë për studentët, stafin akademik dhe administrativ.
- Harmonizimin e infrastrukturës ekzistuese me zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë mjekësor dhe kërkimin shkencor.
- Zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm digjital për menaxhimin akademik, administrativ dhe financiar të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
- Rritjen e kapaciteteve infrastrukturore për kërkimin shkencor, inovacionin dhe transferimin e njohurive.
- Krijimin e një mjedisi funksional dhe stimulues për mësim, punë dhe bashkëpunim ndërdisiplinor.
- Përmirësimin e efikasitetit operacional dhe menaxhimit të burimeve përmes optimizimit të hapësirave dhe teknologjisë.
- Mbështetjen e ndërkombëtarizimit të universitetit përmes infrastrukturës në përputhje me standardet evropiane.

Synohet që:

- Të përfundojë procesi i rikonstruksionit të godinave të Fakultetit të Mjekësisë, përfshirë godinën e Departamentit të Farmacisë dhe Shëndetit Publik;
- Të realizohet ngritja dhe funksionalizimi i laboratorëve modernë të kërkimit shkencor, përfshirë “Infrastrukturën Kërkimore Laboratorike Farmaceutike në Departamentin e Farmacisë”;
- Të përfundojë procesi i regjistrimit të pronave në përdorim të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë;
- Të vijohet me implementimin e laboratorëve të rinj dhe të avancuar të ndërtuar në kuadër të projekteve të kërkimit shkencor me financim të brendshëm dhe të jashtëm;
- Të krijohen ambjente të dedikuara për inovacion, kërkim ndërdisiplinor dhe bashkëpunim me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare;

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË 2025-2030

Shtylla Strategjike	Aktiviteti / Veprimi Konkret	Institucion / Personi Përgjegjës	Afati Kohor	Burimi i Financimit	Treguesit e Performancës (KPI)
1. Ndërkombëtarizimi	1.1 Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit të UMT-së.	Rektorati / Drejtoritë përgjegjëse / Senati Akademik	Dhjetor 2026	Buxheti UMT/ Erasmus+ / Projekte BE	Strategjia miratohet dhe zbatohet.
	1.2 Zgjerimi i partneriteve Erasmus+ dhe marrëveshjeve ndërinstitucionale.	Rektorati / Drejtoritë përgjegjëse / Senati Akademik	Çdo vit	Erasmus+ / Projekte BE	≥10 marrëveshje të reja ndërkombëtare.
	1.3 Zhvillimi i mobilitetit të studentëve dhe stafit.	Zv. Rektori për ndërkombëtarizimin/ Drejtoria përgjegjëse	2026-2030	Erasmus+	Rritje ≥20% e mobiliteteve çdo vit.
	1.4 Hartimi dhe implementimi i programeve të studimit në gjuhën angleze.	Rektorati/ Zv. Rektori për anën mësimore / Dekanatet	2026-2030	Të ardhura dytësore	Të paktën 1 program në gjuhën angleze.
	1.5 Ngritja e Qendrës së Gjuhëve të Huaja.	Rektorati	2026-2030	Të ardhura dytësore	Qendra funksionale dhe ofron trajnim për stafin dhe studentët.

2. Mësimdhënia dhe Cilësia Akademike	2.1 Përditësimi i kurrikulave sipas standardeve evropiane.	Drejtoria përgjegjëse/ Dekanatet / Departamentet	2026–2028	Buxheti UMT	100% e programeve të rishikuara.
	2.2 Harmonizimi i mësimdhënies së shkencave bazë.	Senati Akademik / Fakultetet	2027	Buxheti UMT	Kurrikulë e harmonizuar për të gjitha programet.
	2.3 Zhvillimi i metodave inovative të mësimdhënies.	Departamentet	2026–2030	Projekte / Buxheti UMT	≥70% e lëndëve përdorin metoda aktive të mësimdhënies.
	2.4 Zhvillimi i programeve postdoktorale.	Rektorati / Senati	2028	Projekte	Minimumi 2 programe postdoktorale të hapura.
	3.1 Rritja e pjesëmarrjes në projekte Horizon Europe dhe Erasmus+.	Stafi akademik/ Drejtoritë përgjegjëse për projektet	2026–2030	Horizon Europe / Erasmus+	≥15 projekte të aplikuar çdo vit.
3. Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni	3.2 Ngritja e Grupeve Akademike Klinike (GAK).	Rektorati / Fakultetet	2027	Buxheti UMT	Të paktën 5 GAK funksionale.
	3.3 Përmirësimi i laboratorëve kërkimorë.	Rektorati	2028	Buxheti / Donatorë	Investime në infrastrukturë i laboratorëve prioritarë
	3.4 Rritja e publikimeve në revista Scopus/woS.	Stafi Akademik	2026–2030	Projekte	Rritje ≥15% e publikimeve ndërkombëtare.
	3.5 Krijimi i Qendrës së Studimeve Postdoktorale.	Rektorati	2029	Projekte	Qendra funksionale.

4. Digitalizimi dhe Transformimi Teknologjik	4.1 Implementimi i platformës "e-Universiteti".	Stafi akademik/ Drejtoritë përgjegjëse	Dhjetor 2027	Buxheti UMT/Projekte BE	Identifikimi i proceseve administrative që do të digjitalizohen në nivel institucional; Unifikimi i dokumentacionit dhe flukseve të punës ndërmjet Rektoratit dhe fakulteteve; Standardizimi i të dhënave institucionale për raportim në nivel kombëtar; Koordinimi i procedurave për shkëmbimin elektronik të dokumentacionit ndërmjet njësive të universitetit; Përgatitjen e strukturave për Integrimi me shërbimet elektronike të administratës publike.
	4.2 Digitalizimi i procedurave akademike dhe administrative.	Rektorati/ Fakultetet	2026-2028	Buxheti UMT	≥50% e shërbimeve ofrohen online.
	4.3 Integrimi i Inteligjencës Artificiale në mësimdhënie.	Fakultetet/ Drejtoritë përgjegjëse	2028	Projekte	AI përdoret në të paktën 30% të kurseve si: Krijimi i materialeve mësimore Gjenerimi i prezantimeve. Hartimi i rasteve klinike (case studies). Përgatitja e pyetjeve të provimeve dhe kuizeve. Krijimi i skenarëve për laboratorë dhe simulime. Personalizimi i të nxëniet Rekomandimi i materialeve shtesë sipas performancës së studentit. Ushtrime të ndryshme sipas nivelit të njohurive. Asistentë virtualë (AI Chatbots) Përgjigje automatike për pyetje mbi lëndën. Mbështetje 24/7 për studentët. Vlerësimi Korrigjimi paraprak i testeve me alternativa. Analiza e rezultateve të studentëve. Identifikimi i temave ku studentët hasin më shumë vështirësi. Simulime Pacientë virtualë për studentët e mjekësisë. Simulime të vendimmarrjes klinike. Simulime laboratorike. Kërkimi shkencor Ndihmë në kërkimin e literaturës. Përmbledhje të artikujve shkencorë. Analizë statistikore dhe përpunim të dhënash. Integriteti akademik Udhëzime për përdorimin etik të IA. Politika institucionale për përdorimin e IA në detyra dhe provime.
	4.4 Zhvillimi i Telemjekësisë dhe Teleshëndetit.	Fakultetet/ Drejtoritë përgjegjëse	2028	Projekte	Platforma pilot funksionale.

5. Infrastruktura	5.1 Përfundimi i rikonstruksionit të godinave të Farmacisë dhe Anatomisë.	Rektorati / Drejtoria e Shërbimeve	Dhjetor 2026	Te ardhurat e UMT	Godinat funksionale.
	5.2 Zgjerimi i infrastrukturës së FMD dhe FSHMT.	Rektorati	2027-2029	Te ardhurat e UMT	Te pakten 2 laboratore te rinj
6. Studentët dhe Mirëqenia	5.3. Zhvillimi i Qendrës Multifunksionale të Simulimit Klinik.	MA/ Rektorati	2027-2030	Buxhet Shteti	Qendra funksionale.
	6.1 Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në projekte «rëkimore.	Fakultetet	Çdo vit	Projekte	≥30% e studentëve të përfshirë.
	6.2 Organizimi i internshipeve dhe praktikave klinike.	Fakultetet / Partnerët	Vazhdimisht	Marrëveshje bashkëpunimi	Rritje e numrit të institucioneve partnere dhe marrëveshjeve aktive për zhvillimin e praktikave klinike dhe profesionale, të paktën 20%.
	6.3 Krijimi i Grupeve Shkencore të Studentëve.	Fakultetet	2026-2030	Buxheti UMT	Minimumi 6 grupe aktive në çdo fakultet.
	6.4 Mbështetja financiare për studentët dhe skemat e kreditimit.	Rektorati	2026-2030	Buxheti i Shtetit	Rritje e numrit të studentëve që përfitojnë nga skemat e mbështetjes financiare, përfshirë financimin e studentëve të doktoraturës nëpërmjet programeve të AKKSHI dhe READ, si dhe zgjerimi i mundësive të financimit për studentët.

7. Menaxhimi Institucional dhe Financat	7.1 Rritja e të ardhurave nga projektet ndërkombëtare.	Rektorati / Drejtoria përgjegjëse për projektet	Çdo vit	Horizon Europe / Erasmus+	Rritje ≥20% e fondeve të përfituara.
	7.2 Krijimi i strukturës për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve.	Rektorati / Drejtoria përgjegjëse për projektet	2026	Buxheti UMT	Struktura funksionale.
	7.3 Rritja e transparencës financiare dhe raportimit.	Administratori dhe Drejtoria përgjegjëse	Çdo vit	Buxheti UMT	Raporte periodike të publikuara.
	7.4 Diversifikimi i burimeve të financimit.	Rektorati	2026-2030	Projekte / Donacione / Shërbime	≥30% e financimit nga burime alternative.